



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



RREGULLORE

PËR

PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES
NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS
SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Suharekë-2021

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja (c), lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja (c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 6, pika 1, nënpika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, 'Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019', e konform nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 15, 29, pika 2, lidhur me nenin 47, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën ----- miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË VIT (1) TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohen, kriteret kushtet dhe procedurat dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për interes publik, për periudhën më pak se një (1) vit.

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga organet e komunës, personat fizik dhe juridik në territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 3 **Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin, siç është përkufizuar në Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 4 **Parimet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës bëhet duke u bazuar në këto parime:

1.1. Parimi i ligjshmërisë - nënkupton se dhënia në shfrytëzim dhe këmbimi i pronës së paluajtshme të komunës duhet të bazohen në Kushtetutë, ligj dhe aktet e tjera nënligjore;

1.2. Parimi i efikasitetit - nënkupton se organet e komunës zhvillojnë procedurën për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, sa më shpejtë dhe sa më pak shpenzime për komunën dhe për palët, duke siguruar edhe qëllimin e dhënies së pronës për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal;

1.3 Parimi i trajtimit të barabartë të palëve - nënkupton se të gjitha palët në procesin e dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, trajtohen në mënyrë të barabartë, duke shmangur çdo diskriminim ndaj palëve dhe duke vepruar në mënyrë objektive dhe të paanshme ndaj të gjithëve;

1.4. Parimi i transparencës - nënkupton se organet e komunës duhet të veprojnë me transparencë, të respektojnë dhe të garantojnë të drejtat e palëve për t'u informuar lidhur me procedurat, kushtet dhe ecurinë e dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës;

1.5. Parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës së pronës publike të komunës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale është i detyruar që pronën ta shfrytëzoj në atë mënyrën që ta ruaj vlerën e saj dhe të përdorë të gjitha masat përkatëse për rritjen e kësaj vlere;

1.6. Parimi i ruajtjes së karakteristikave dhe vlerave unike të pronës - nënkupton se shfrytëzuesi i pronës komunale, duhet ta shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës duke ruajtur vlerat e saj kulturore, historike, arkeologjike, arkitekturën historike dhe çdo vlerë tjetër unike të saj, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit

1. Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit.
2. Pronat e paluajtshme e komunës të cilat mund të jepet në shfrytëzim për më pak se një (1) vit, janë si më poshtë:
 - 2.1 Hapësirat publike, (parqet, sheshet, bulevardet, panot reklamuese dhe të ngjajshme);
 - 2.2 Shtëpitë e kulturës, kinematë, teatrot dhe terrenet rekreative-sportive;
 - 2.3 Hapësirat publike para lokaleve;
 - 2.4 Lokalet në pronësi të komunës, (që kanë karakter të përkohshëm, kiosqet, ekspozimet objektet dhe të ngjajshme);
 - 2.5 Hapësirat publike rreth vend punishteve;
3. Kompensimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një (1) vit përcaktohet me rregullore të komunës për taksa komunale.

Neni 6

Kriteret për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit jepet, duke u bazuar në kriteret vijuese:
 - 1.1 Të jetë e regjistruar si pronë e komunës në regjistrat kadastrale të pronës;
 - 1.2 Të jetë e lirë nga obligimet ndaj palëve të treta;
 - 1.3 Të mos ketë ndonjë kontest pronësor;
 - 1.4 Të jetë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor;
 - 1.5 Të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore;
 - 1.6 Të ketë arsyeshmërinë të interesit publik;
 - 1.7 Të ndikojë në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunë;
 - 1.8 Të ndikojë në rritjen e vlerave e diversitetit arsimor, kulturore-sportiv e të ngjashme;

Neni 7

Procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për periudhën më pak se një (1) vit

1. Prona e paluajtshme e komunës jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shprehin interesim përmes një kërkesë zyrtare me shkrim.
2. Kërkesa duhet t'i drejtohet organin kompetent, drejtorisë përkatëse:
 - 2.1. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike, kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Urbanizmit dhe Planifikim;
 - 2.2. Për dhënien në shfrytëzim për objektet kulturore, rinore dhe sportive dhe të ngjajshme kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë;
 - 2.3. Për dhënien në shfrytëzim të lokaleve në pronësi të komunës, (që kanë karakter të përkohshëm, kiosqet, ekspozitat dhe të ngjajshme) kërkesa i drejtohet drejtorisë për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër;
 - 2.4. Për dhënien në shfrytëzim të hapësirave publike rreth vend punishteve, kërkesa i drejtohet Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedisë dhe Emergjencë;
3. Prona e cila jepet në shfrytëzim mbi bazën e kërkesës së aplikuesit duhet të shfrytëzohet vetëm për destinimin e kërkuar e jo për qëllime të tjera.

Neni 8

Kushtet për aplikim

1. Personat fizik dhe juridik me rastin e aplikimit për të marrë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës duhet të bashkangjesin këto dokumente:
 - 1.1. Formularin e plotësuar me të dhënat e kërkuara nga drejtoria përkatëse;
 - 1.2. Certifika e pronësisë;
 - 1.3. Kopja e planit;
 - 1.4. Skicë tereni (në raste të veçanat sipas kërkesës së Drejtorisë)
 - 1.5. Kopja e letërnjoftimit për personat fizik;
 - 1.6. Certifikata e regjistrimit të biznesit për personat juridik;
 - 1.7. Historiati i biznesit që aplikon;
 - 1.8. Veprimtaria që do të zhvillojë;
 - 1.9. Projekti ideor;
 - 1.10. Vërtetimi nga komunat për përmbushjen e obligimeve të tatimit në pronë dhe taksave komunale;
2. Në rast se dokumentet të cilat kërkohen në aplikimin për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës nuk janë të kompletuara, kërkesa refuzohet nga ana e drejtorisë përkatëse.

Neni 9

Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për Organizatat e shoqërisë civile

1. Dhënia në shfrytëzim e pronës së komunës për organizatat e shoqërisë civile për periudhën më pak se një (1) vit jepet me procedura të njëjta siç është përcaktuar me këtë rregullore.
2. Dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës për organizatat e shoqërisë civile jepet nga një (1) ditë deri në dhjetë (10) ditë të cilat kanë për qëllim ushtrimin e veprimtarive në kuadër të kompetencave vetanake të komunës, për promovimin e vlerave kulturore, historike, arkeologjike, sportive, rinore, arkitekturën historike, e të ngjashme.
3. Organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë për qëllim ushtrimin e aktiviteteve të cekura në paragrafin 2 të këtij neni prona e paluajtshme iu jepet në shfrytëzim vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.
4. Organizatat e shoqërisë civile të cilat ushtrojnë veprimtarinë apo aktivitetet rehabilituese për personat me nevoja të veçanta, prona e paluajtshme e komunës mund të iu jepet në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit, vetëm mbi bazën e kërkesës dhe aprovimit nga drejtori i drejtorisë, duke përjashtuar shqyrtimin e kërkesës nga ana e komisionit vlerësues.

Neni 10

Formimi dhe përbërja e komisionit

1. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për secilën drejtori e cila në bazë të kësaj rregulloreje ka kompetencë dhe autoritet të jep në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës.
2. Komisioni do të ketë përbërje, prej tre (3) anëtarëve, ku kryesues i komisionit do të jetë zyrtari nga drejtoria së cilës i është drejtuar kërkesa për marrjen në shfrytëzim të pronë së paluajtshme të komunës, ndërsa dy anëtar mund të jenë nga drejtoritë tjera të fushave profesionale.
3. Komisioni ka për obligim që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës të bëjë shqyrtimin e kërkesës, të konstatojë gjendjen faktike në teren, se a është në harmoni dhe përputhshmëri me arsyeshmërinë e kërkesës.
4. Pas shqyrtimit të kërkesës, komisioni duhet të bëjë raport përfundimtar dhe të rekomandojë për palën përfituese.
5. Mandati i komisionit do të jetë dy (2) vite.

Neni 11

E drejta e ankesës

1. Pala e pakënaqur kundër procesit të vlerësimit të kërkesës ka të drejtë ankese në komisionin e ankesave të komunës, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
2. Kryetari i Komunës nxjerr vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave;
3. Përbërja e komisionit do të jetë prej pesë (5) anëtar, ku njëri nga anëtarët e komisionit duhet të jetë jurist, ndërsa të tjerët profesionist sipas drejtorive përkatëse.
4. Vendimi i komisionit të ankesave për miratimin apo refuzimin e ankesës së palës është përfundimtar në procedurën administrative në Komunë.
5. Komisioni për ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimi të ankesës bën shqyrtimin e ankesës;
6. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit të ankesave brenda afatit ligjor prej tridhjetë ditësh (30) nga dita e marrjes së vendimit, mund të iniciojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.
7. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave do të jete dy (2) vite.

Neni 12

Konflikti i interesit

1. Anëtarët e Komisionit përjashtohen nga procesi vendimmarrës nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

2. Anëtarët e Komisionit vlerësues përjashtohen nga procesi vlerësues nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
3. Anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankesave përjashtohen nga procesi i shqyrtimit të ankesave nëse ai ose ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal ose material, lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 13

Nënshkrimi i kontratës

1. Bazuar në rekomandimin e komisionit vlerësues dhe pas kalimit të afatit të ankesës, Drejtori i Drejtorisë përkatëse e nënshkruan kontratën me të përzgjedhurin, në të cilën kontratë përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
2. E drejta e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës më pak se një (1) vit, nuk mund të bartet te personat e tretë.

II. DISPOZITAT E VEQANTA

Neni 14

Mbikëqyrja e kontratës

1. Drejtoria përkatëse bën mbikëqyrjen e realizimit të kontratës se a është duke e shfrytëzuar pala sipas kushteve të kontratës.
2. Në rast të mos përmbushjes së kontratës, apo shmangies nga qëllimi për të cilën është marrë prona në shfrytëzim sipas kërkesës së palës, drejtoria përkatëse do të përgatis raport përfundimtar me të cilin do të rekomandoj Kryetarin e Komunës për shkëputje të njëanshme të kontratës.
3. Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të raportit përfundimtar të përgatitur nga drejtoria përkatëse dhe duke u bazuar në rekomandimin e dhënë do ta shkëpus kontratën në mënyrë të njëanshme, duke e njoftuar shtatë (7) ditë para ndërprerjes së kontratës palën kontraktuese.
4. Komuna është e obliguar që të publikojë listën e pronave të cilat i kanë dhënë në shfrytëzim për periudhën më pak se një (1) vit sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
5. Publikimi i listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim bëhet brenda shtatë (7) ditësh nga dita e nënshkrimit të kontratës.
6. Kontrata mund të shkëputet para afatit, me marrëveshjen e palëve kontraktuese, si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligje në fuqi apo të përcaktuara me kontratë.

Neni 15

Mirëmbajtja e pronës së komunës

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale, janë të detyruar që ato t'i mirëmbajnë dhe t'i shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar konform kontratës për shfrytëzim;
2. Personat fizik dhe juridik dhe të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës, janë të detyruar të kujdesen për mbrojtjen e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me këtë Rregullore.

III. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Suharekës të cilat bien ndesh me dispozitat e kësaj Rregullore.

Neni 17 Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18 Zbatimi

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 19 Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr.03/L-040, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 016-20161
Me datë 30.03.2021



Kryesuesi Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI



Na osnovu člana 11 i 12.2 slova (c), u vezi sa članom 17 stav 1 slova (c), zakona br. 03 / L-040 o lokalnoj samoupravi „Službeni list Republike Kosovo br. 28/2008“, u skladu sa članom 6, tačka 1, podtačka 1.3 Zakona br. 06 / L-092 o davanju na korišćenje i razmena nepokretne imovine opštine, „Službeni list Republike Kosovo br. 10/2019“, u skladu sa članom 7 Uredbe (KRK) br. 09/2020 o određivanju postupaka za odobravanje korišćenja i zamene nepokretne imovine opština i članovi 15, 29, tačka 2, povezani sa članom 47, Statuta opštine Suva Reka, 01-No.-8336, od 04.11.2008, Skupština opštine u Suvoj Reci na sastanku održanom 30.03.2021 odobrio ovo:

P R A V I L N I K
O ODREĐIVANJU POSTUPKA ZA ODOBRENJE UPOTREBE MANJE OD
GODINE (1) OPŠTINSKE NEPOKRETNOSTI

I. OPŠTE ODREDBE

Član 1

Svrha

Ovaj Pravilnik utvrđuje kriterijume, uslove i postupke za odobravanje korišćenja nepokretne imovine opštine od javnog interesa za period kraći od jedne (1) godine.

Član 2

Obim

Odredbe ovog Pravilnika sprovode opštinski organi, fizička i pravna lica na teritoriji opštine Suva Reka.

Član 3

Definicije

Izrazi korišćeni u ovoj uredbi imaju značenje, kako je definisano Zakonom br. 06 / L-092 o dodeljivanju i zameni nepokretne imovine opštine.

Član 4

Principi davanja u zakup nepokretne imovine opštine

1. Puštanje u rad nepokretne imovine opštine vrši se na osnovu sledećih principa:

1.1. Načelo zakonitosti - znači da se davanje na korišćenje i razmena nepokretne imovine opštine mora zasnivati na Ustavu, zakonu i drugim podzakonskim aktima;

1.2. Načelo efikasnosti - znači da opštinski organi razviju postupak zakupa i zamene nepokretne imovine opštine, što je pre moguće i što je manje moguće za opštinu i stranke, osiguravajući svrhu dodele imovine da zadovolji kamate javni i lokalni ekonomski razvoj;

1.3 Načelo jednakog tretmana strana - znači da se prema svim strankama u postupku odobravanja korišćenja i razmene nepokretne imovine opštine postupa jednako, izbegavajući bilo kakvu diskriminaciju stranaka i delujući objektivno i nepristrasno prema svima;

1.4. Načelo transparentnosti - znači da opštinski organi moraju da deluju transparentno, poštujući i garantujući prava stranaka da budu obaveštene o postupcima, uslovima i napretku u odobravanju korišćenja i razmene opštinske nepokretne imovine;

1.5. Načelo očuvanja i povećanja vrednosti javne svojine opštine - znači da je korisnik opštinske imovine dužan da imovinu koristi na način da očuva njenu vrednost i da koristi sve odgovarajuće mere za povećanje ove vrednosti;

1.6. Princip očuvanja jedinstvenih karakteristika i vrednosti dobra - znači da korisnik opštinske imovine treba da koristi imovinu samo prema odredištu dobra uz očuvanje njenih kulturnih, istorijskih, arheoloških vrednosti, istorijske arhitekture i bilo kog drugog jedinstvenu vrednost, kako je definisano važećim zakonodavstvom.

Član 5

Davanje u zakup nepokretne imovine opštine na manje od jedne (1) godine

1. Opštine mogu da daju u zakup nepokretnu imovinu opštine na manje od jedne (1) godine.

2. Nepokretne imovine opštine koje se mogu dati na korišćenje kraće od jedne (1) godine su sledeće:

2.1 Javni prostori (parkovi, trgovi, bulevari, bilbordi i slično);

2.2 Domovi kulture, bioskopi, pozorišta i rekreativno-sportski tereni;

2.3 Javni prostori ispred prostorija;

2.4 Prostori u vlasništvu opštine (koji imaju privremeni karakter, kiosci, izložbeni objekti i slično);

2.5 Javni prostori oko mesta radionice;

3. Naknada za zakup nepokretne imovine opštine na manje od jedne (1) godine utvrđena je opštinskim propisima za opštinske takse.

Član 6

Kriterijumi za zakup nepokretne imovine opštine

1. Odobrava se puštanje u rad nepokretne imovine opštine za period kraći od jedne (1) godine, na osnovu sledećih kriterijuma:
 - 1.1 Da bude registrovan kao imovina opštine u katastarskim registrima imovine;
 - 1.2 Da se oslobodite obaveza prema trećim licima;
 - 1.3 Ne bi trebalo da bude imovinskog spora;
 - 1.4 pridržavanje dokumenata prostornog planiranja;
 - 1.5 Da bi se ispunili definisani uslovi i kriterijumi okoline;
 - 1.6 da imaju razumnost javnog interesa;
 - 1.7 Da utiče na rast ekonomskog razvoja u opštini;
 - 1.8 Uticati na povećanje vrednosti obrazovne, kulturno-sportske i slične raznolikosti;

Član 7

Postupci zakupa opštinske nepokretne imovine na period kraći od jedne (1) godine

1. Nepokretna imovina opštine daje se na korišćenje za period kraći od jedne (1) godine za sva fizička i pravna lica koja izraze interes putem formalnog pismenog zahteva.
2. Zahtev mora biti upućen nadležnom telu, relevantnoj direkciji:
 - 2.1. Za korišćenje javnih prostora, zahtev je upućen Direkciji za urbanizam i planiranje;
 - 2.2. Za puštanje u rad objekata kulture, omladine i sporta i slično, zahtev je upućen Direkciji za kulturu, omladinu, sport i dijasporu;
 - 2.3. Za upotrebu prostorija u vlasništvu opštine (koje imaju privremeni karakter, kioske, izložbene objekte i slično) zahtev se obraća Direkciji za pravne imovinsko-pravne usluge i katastar;
 - 2.4. Za upotrebu javnih prostora oko radionica, zahtev je upućen Direkciji za javne službe, životnu sredinu i vanredne situacije;
3. Imovina koja je data na korišćenje na osnovu zahteva podnosioca zahteva treba da se koristi samo za traženo odredište, a ne u druge svrhe.

Član 8

Uslovi za prijavu

1. Fizička i pravna lica prilikom podnošenja zahteva za korišćenje nepokretne imovine opštine moraju priložiti sledeće dokumente:

- 1.1. Popunjen obrazac sa podacima koje zahteva nadležna direkcija;
- 1.2. Potvrda o vlasništvu;
- 1.3. Kopija plana;
- 1.4. Opis terena (u posebnim slučajevima na zahtev Direkcije)
- 1.5. Kopija lične karte za fizička lica;
- 1.6. Potvrda o registraciji preduzeća za pravna lica;
- 1.7. Istorija poslovanja aplikacija;
- 1.8. Aktivnost koja će se odvijati;
- 1.9. Idejni projekat;
- 1.10. Certifikacija od strane opština za ispunjenje poreza na imovinu i opštinskih poreskih obaveza;

2. U slučaju da dokumenti potrebni u prijavi za korišćenje nepokretne imovine opštine nisu kompletni, nadležna direkcija odbija zahtev.

Član 9

Davanje u zakup opštinskih nekretnina organizacijama civilnog društva

1. Korišćenje opštinske imovine za organizacije civilnog društva za period kraći od jedne (1) godine odobravaće se istim postupcima definisanim ovom uredbom.
2. Odobravanje korišćenja nepokretne imovine opštine za organizacije civilnog društva daje se od jednog (1) dana do deset (10) dana čiji je cilj vršenje aktivnosti iz sopstvenih nadležnosti opštine, za unapređenje vrednosti.kulturna, istorijska, arheološka, sportska, omladinska, istorijska arhitektura i slično.
3. Organizacijama civilnog društva koje nameravaju da vrše aktivnosti iz stava 2. ovog člana, nepokretnost se daje na korišćenje samo na osnovu zahteva i odobrenja direktora direkcije, isključujući razmatranje zahteva od strane komisija.evaluator.
4. Organizacijama civilnog društva koje obavljaju delatnost ili rehabilitaciju za osobe sa posebnim potrebama, nepokretna imovina opštine može se dati na korišćenje na period kraći od jedne (1) godine, samo na osnovu zahteva i odobrenja direktor direkcije, isključujući razmatranje zahteva od komisije za ocenjivanje.

Član 10

Formiranje i sastav komisije

1. Gradonačelnik donosi odluku o obrazovanju komisije za svaku direkciju koja, na osnovu ove uredbe, ima nadležnost i ovlašćenje da koristi nepokretnu imovinu opštine.
2. Komisija će se sastojati od tri (3) člana, pri čemu će predsednik komisije biti službenik iz direkcije kojoj je upućen zahtev za preuzimanje nepokretne imovine opštine, dok dva člana mogu biti iz direkcije ostale stručne oblasti.
3. Komisija ima obavezu da preispita zahtev u roku od sedam (7) dana od dana podnošenja zahteva, kako bi utvrdila činjenično stanje na terenu, da li je u skladu i da li je u skladu sa razumnošću zahteva.
4. Nakon razmatranja zahteva, komisija mora da sačini završni izveštaj i da preporuku korisniku.
5. Mandat komisije biće dve (2) godine.

Član 11

Pravo na žalbu

1. Nezadovoljna stranka protiv postupka ocene zahteva ima pravo žalbe opštinskoj komisiji za žalbe, u roku od sedam (7) dana od dana donošenja odluke.
2. Gradonačelnik donosi odluku o obrazovanju komisije za razmatranje žalbi;
3. Sastav komisije biće pet (5) članova, pri čemu jedan od članova komisije mora biti pravnik, dok su ostali profesionalni prema odgovarajućim direkcijama.
4. Odluka žalbene komisije da odobri ili odbije žalbu stranke je konačna u upravnom postupku u opštini.
5. Komisija za žalbe u roku od sedam (7) dana od dana prijema žalbe razmatra žalbu;
6. Stranke nezadovoljne odlukom žalbene komisije u zakonskom roku od trideset (30) dana od dana donošenja odluke, mogu pokrenuti upravni spor pred nadležnim sudom.
7. Mandat komisije za razmatranje žalbi biće dve (2) godine.

Član 12

Sukob interesa

1. Članovi Komisije su isključeni iz procesa donošenja odluka ako on ili bilo koji član uže porodice ima lični ili materijalni interes u vezi sa zakupom nepokretne imovine opštine.

2. Članovi komisije za procenu isključeni su iz postupka ocenjivanja ako on ili bilo koji član uže porodice ima lični ili materijalni interes u vezi sa zakupom nepokretne imovine opštine.

3. Članovi Komisije za razmatranje žalbi isključeni su iz postupka razmatranja žalbi ako on ili član uže porodice ima lični ili materijalni interes za korišćenje nepokretne imovine opštine.

Član 13

Potpisnik ugovora

1. Na osnovu preporuke komisije za ocenjivanje i nakon isteka roka za žalbu, direktor relevantne direkcije potpisuje ugovor sa izabranim, u kojem ugovor definiše prava i obaveze ugovornih strana.

2. Pravo na korišćenje nepokretne imovine opštine kraće od jedne (1) godine ne može se preneti na treće strane.

II. POSEBNE ODREDBE

Član 14

Nadzor ugovora

1. Relevantna direkcija nadgleda sprovođenje ugovora bez obzira da li ga stranka koristi u skladu sa uslovima ugovora.

2. U slučaju neispunjavanja ugovora ili odstupanja od svrhe zbog koje je imovina uzeta u upotrebu na zahtev stranke, nadležna direkcija će pripremiti konačni izveštaj koji će preporučiti gradonačelnika za jednostrani raskid ugovora. ugovor.

3. Gradonačelnik će nakon pregleda konačnog izveštaja koji je pripremila relevantna direkcija i na osnovu date preporuke jednostrano raskinuti ugovor, obavestivši ugovornu stranu sedam (7) dana pre raskida ugovora.

4. Opština je dužna da objavi spisak imovine koja je puštena u upotrebu kraće od jedne (1) godine u skladu sa odredbama ove uredbe.

5. Objavljivanje spiska nepokretne imovine opštine koja je data na korišćenje vrši se u roku od sedam (7) dana od dana potpisivanja ugovora.

6. Ugovor se može raskinuti pre isteka roka, uz saglasnost ugovornih strana, kao i u drugim slučajevima utvrđenim važećim zakonima ili utvrđenim ugovorom.

Član 15

Održavanje opštinske imovine

1. Svi korisnici opštinske imovine dužni su da ih održavaju i koriste na određeni način u skladu sa ugovorom o korišćenju;
2. Fizička i pravna lica i svi korisnici nepokretne imovine opštine dužni su da se staraju o zaštiti nepokretnosti, kako je predviđeno ovom uredbom.

III. PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE

Član 16 Ukidanje

Stupanjem na snagu ove uredbe ukidaju se propisi i odluke koje je usvojila Skupština opštine Suva Reka, a koji su u suprotnosti sa odredbama ove uredbe.

Član 17 Nadmoć nad zakonima i drugim podzakonskim aktima

U slučajevima sukoba i nepridržavanja odredbi ove uredbe i odredbi zakona i drugih podzakonskih akata, primenjivaće se odredbe zakona i drugih podzakonskih akata koji se primenjuju u Republici Kosovo.

Član 18 Aplikacija

O sprovođenju ove uredbe brinuće se gradonačelnik i direktori direkcija opštine Suva Reka.

Član 19 Stupanje u snagu

Nakon odobrenja od strane Skupštine opštine u Suvoj Reci, ova uredba stupa na snagu 15 dana nakon podnošenja nadzornom organu, u smislu člana 81. Zakona o lokalnoj samoupravi, br. 03 / L-040, „Službeni list Republika Kosovo, br. 28/2008 ”), član 8., u vezi sa članom 9. Uredbe, br. 10/2019, o postupcima za izradu i objavljivanje akata opština i nakon javnog objavljivanja na oglasnoj tabli ili vebajst službenik opštine.

SKUPŠTINA OPŠTINE SUVA REKA

01-Br- 016-20161
Dana: 30.03.2021

